146/2026

Në mbështetje të nenit 3, paragrafit 3.1, nenit 6 (paragrafët 6.1, 6.6 dhe 6.7), nenit 7 (paragrafët 7.1.1, 7.1.2 dhe 7.6.1), nenit 9 të Rregullores për Procedurën dhe Masat Disiplinore të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), Komisioni Disiplinor i FVK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore dhe shqyrtimit të provave, mori këtë:

## V E N D I M

I. Leutrim Mujaj, në cilësinë e lojtarit të KV Peja, shpallet përgjegjës për shkelje disiplinore të manifestuar përmes sjelljes së rëndë josportive, agresive dhe kërcënuese ndaj gjyqtarit të parë në ndeshjen KV Peja – KV Ferizaj, të zhvilluar më 21.10.2026.

II. Leutrim Mujajt i shqiptohet masa disiplinore e ndalimit të pjesëmarrjes në të gjitha garat zyrtare të FVK-së për një (1) vit.

III. Leutrim Mujajt i shqiptohet gjobë financiare në shumën prej 1.000,00 (një mijë) eurosh.

IV. Pas përfundimit të masës së ndalimit, lojtari nuk mund të paraqitet apo të aktivizohet në garat zyrtare të FVK-së pa i përmbushur obligimet financiare që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me aktet normative të FVK-së.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

## A R S Y E T I M

Pas pranimit të vendimit të Komisarit të Garave për suspendim të përkohshëm dhe inicim të procedurës disiplinore ndaj lojtarit Leutrim Mujaj, lidhur me ndeshjen KV Peja – KV Ferizaj, të zhvilluar më 21.10.2026, Komisioni Disiplinor i FVK-së ka mbajtur mbledhjen e parë më 23.10.2026 dhe mbledhjen e radhës më 30.10.2026, në të cilat ka shqyrtuar rastin dhe provat përkatëse. Gjatë procedurës, Komisioni ka administruar raportin zyrtar të delegatit, deklaratat e zyrtarëve të ndeshjes, deklaratën e klubit dhe të lojtarit, si dhe video-incizimin e incidentit.

Nga shqyrtimi i video-incizimit, Komisioni Disiplinor ka konstatuar se lojtari Leutrim Mujaj, pas një vendimi të kontestuar të gjyqtarëve në setin e katërt, ka manifestuar sjellje tejet agresive, kërcënuese dhe të papërshtatshme ndaj gjyqtarit të parë, duke bërë përpjekje të vazhdueshme dhe të përsëritura për t'iu afruar atij në mënyrë konfrontuese. Siç evidentohet qartë në video-incizim, lojtari është penguar vazhdimisht dhe me vështirësi të madhe nga bashkëlojtarët për disa minuta. Intensiteti, vazhdimësia dhe natyra e këtyre

veprimeve përbëjnë sjellje të rëndë josportive, e cila cenon autoritetin e gjyqtarëve, rendin dhe disiplinën sportive, si dhe krijon shqetësim serioz për sigurinë e zyrtarëve të ndeshjes.

Gjyqtari i dytë ka përshkruar kundërshtimin verbal dhe goditjen e rrjetës, duke sqaruar se nuk ka pasur tentim sulmi ndaj tij. Klubi ka pranuar papërshtatshmërinë e reagimit dhe ka theksuar ndërhyrjen për qetësimin e situatës. Lojtari, në deklaratën e tij, ka kërkuar falje dhe ka pranuar përgjegjësinë për sjelljen.

Në përcaktimin e masës disiplinore, Komisioni ka vlerësuar si rrethana rënduese intensitetin dhe përsëritjen e sjelljes agresive e kërcënuese të evidentuar në video-incizim, vazhdimësinë e incidentit për disa minuta, ndërhyrjet e domosdoshme të bashkëlojtarëve për të penguar konfrontimin dhe cenimin e autoritetit e sigurisë së zyrtarëve të ndeshjes. Komisioni ka shqyrtuar gjithashtu recidivizmin e lojtarit si rrethanë rënduese, që duhet të mbështetet në vendimet e mëparshme disiplinore të administruara në dosjen e rastit.

Komisioni ka marrë në konsideratë deklaratën me shkrim të lojtarit Leutrim Mujaj, në të cilën ai pranon përgjegjësinë për reagimin e papërshtatshëm, shpreh pendim dhe keqardhje të sinqertë, kërkon falje ndaj personave të pranishëm në ndeshje dhe zotohet se sjellje të tilla nuk do të përsëriten. Këto elemente janë vlerësuar si rrethana lehtësuese gjatë individualizimit të masës disiplinore, pa e përjashtuar përgjegjësinë për sjelljen e konstatuar.

## P Ë R F U N D I M

Duke peshuar rëndësinë e sjelljes së konstatuar nga video-incizimi, përpjekjet e përsëritura për konfrontim me gjyqtarin e parë, kohëzgjatjen e incidentit, nevojën për mbrojtjen e sigurisë dhe autoritetit të gjyqtarëve, recidivizmin e dokumentuar në dosje dhe rrethanat lehtësuese, Komisioni vlerësoi se ndalimi i pjesëmarrjes për një (1) vit dhe gjoba prej 1.000,00 eurosh janë masa proporcionale, me karakter ndëshkues dhe parandalues, dhe vendosi si në dispozitiv.

**KOMISIONI DISIPLINOR**

Gani Beqiri, anëtar | Fidan Hamiti, kryetar | Liridon Dalipi, anëtar

**Vendimi t'u dërgohet:**

1. Leutrim Mujajt;
2. KV Peja;

E-mail: info@fvk-ks.org
www.fvk-ks.org

3. Komisarit të Garave;

4. Zyrtarëve të ndeshjes;

5. Kryetarit të FVK-së;

6. Sekretarit të Përgjithshëm të FVK-së;

7. Arkivit të FVK-së.

**KËSHILLË JURIDIKE**

Në mbështetje të nenit 12.1 të Rregullores Disiplinore, kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë në Komisionin e Ankesave të FVK-së brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, kundrejt pagesës së tarifës së ankesës prej 300,00 eurosh, sipas rregullores.